



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 17 qershor 2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Valdete Bajrami.

Munguan: Besnik Bislimi dhe Duda Balje.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi, Saranda Kaçi, praktikante dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Avdullah Hoti- Ministër në Ministrinë e Financave, Kimete Arifi dhe Afrim Shala-NJQHAB e Ministrisë së Financave, Kaltrina Ahmeti - GLPS, Florina Merovci- ZPRK, dhe Qëndresa Mulaj – ZAP.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, zv.kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 03.06.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2014;
4. Të ndryshme.

Rend i ditës:

Zv.kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 03.06.2015

***Zv.kryetari** konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 03.06.2015, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2014

Zv. kryetari - Theksoi se raporti në vete përmban dy pjesë: Raportin mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në të cilin flet për auditimin e brendshëm dhe Njësinë Qendrore Harmonizuese. Në raport është cekur se vetëm 83% të organizatave buxhetore (89 nga 107 gjithsej) kanë plotësuar pyetësin për vetëvlerësim. Edhe pse këtë NJQHAB e ka konsideruar si sukses nga viti i kaluar, ku kishte një rritje prej 31 organizatave buxhetore të cilat e kishin plotësuar këtë pyetësor, por që ende mbeten edhe 18 organizata, të cilat nuk e kanë plotësuar këtë formular. Çfarë është bërë me këto institucione dhe cila është arsyeja që nuk e plotësojnë formularin e vetëvlerësimit?

Gjithashtu në raport është cekur se diku 7% e njërive të Auditimit të Brendshëm nga sa janë 72 gjithsej nuk kanë raportuar te NJQHAB. Kjo gjithashtu është një çështje e cila duhet të diskutohet. Duke pasur parasysh faktin që një raportim i tillë është obligim ligjor konsiderojmë që udhëheqësit e njërive të Auditimit të Brendshëm (AB) duhet të kenë ofruar një shpjegim pranë NJQHAB për këtë çështje. Pse nuk kanë raportuar këto njësi te NJQHAB dhe cilat janë masat të cilat NJQHAB i ka marrë lidhur me këtë çështje?

Në raport është theksuar që në 19 organizata të vogla buxhetore nuk është realizuar funksioni i auditimit të brendshëm. Do të ishte i nevojshëm një shpjegim pse nuk është bërë një gjë e tillë? Pasur parasysh faktin se në raport gjithashtu është cekur se kishte 5 institucione të cilat kishin përdorur shërbimet e përbashkëta të Auditimit të Brendshëm atëherë pse një gjë e tillë nuk është bërë edhe te këto 19 organizata të vogla buxhetore?

Mos adresimi i rekomandimeve të auditorit nga ana e Menaxhmentit është një çështje mjaft shqetësuese që përgjegjësit e institucioneve, duhet ta trajtojnë me urgjencë. Fakti që Menaxhmenti nuk i adreson rekomandimet e Auditorit, atëherë funksioni i Auditimit të Brendshëm është i pa vlerë dhe nuk sjell asnjë vlerë të shtuar për atë institucion. Çështja e auditorëve të licencuar duhet shpjeguar në mënyrë më detaje. Pse kemi vetëm 67 auditorë të licencuar nga 149 sa janë gjithsej? A nuk kanë marrë pjesë në trajnime apo nuk kanë arritë prapë e kalueshmërisë? A kryejnë punët e njëjta dhe a kanë benefite të njëjta sikur ata të cilët posedojnë licencë dhe ata të cilët nuk posedojnë këto licenca? A ju është dhënë ndonjë afat për përfundimin e licencimit? Me këtë e hapi diskutimin.

Avdullah Hoti - Shtoi se për pyetjet më në detaje do të përgjigjen zyrtarët nga NJQHAB dhe më pastaj unë, si ministër i Financave, do të jem në dispozicionin e juaj për adresimin e rekomandimeve që dalin nga shqyrtimi i raportit të NJQHAB.

Kimete Arifi- Tha se sa i përket pyetjes së juaj se pse OB nuk kanë plotësuar format e vetëvlerësimit theksoi se NJQHAB ka pranuar format e plotësuar të vetëvlerësimit nga OB të

cilat kanë raportuar te NE, megjithatë një numër prej tyre nuk i ka plotësuar format e vetëvlerësimit, si ZAP, Komuna e Prishtinës etj. Plani i NJQHAB është që pas pranimi të formave të vetëvlerësimit NE të hartojmë planin e veprimeve dhe të shikojmë shkaqet pse të gjitha OB- të nuk i kanë dorëzuar format e vetëvlerësimit. Ne, si NJQHAB, përgatisim raport me shkrim dhe njoftojmë ministrin e Financave për shkaqet e mos plotësimit të formës së vetëvlerësimit nga të gjitha OB-të.

Afrim Shala - Theksoi se nëse krahasohet viti 2013 me vitin 2014 shihet se ka një progres, ngase nga 58% sa nuk ishin plotësuar format e vetëvlerësimit në vitin 2013, tani kjo në vitin 2014 është ra në 38%, pra vërehet një lëvizje pozitive.

Adem Grabovci falënderoi Ministrinë e Financave për angazhimin e tij në adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me fushën e auditimit të brendshëm. Megjithatë ai nuk pajtohet se pse ZAP, Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Gjakovës, nuk e kanë bërë plotësimin e formave të vetëvlerësimit.

Kimete Arifi - Tha se sa i përket NJQHAB, NE në këtë rast e luajmë rolin këshillëdhënës për OB në plotësimin e formave të vetëvlerësimit. Ligji i AB- së e cakton shumë qartë se si mund të mbulohen të gjitha institucionet e vogla, e kjo mundësohet përmes shërbimeve të përbashkëta të auditimit, megjithatë disa OB, të cilat janë Agjenci të Pavarura nuk janë pajtuar të kenë auditim të brendshëm nga MF për shkak se arsyetohet me atë se janë të themeluara nga Kuvendi dhe i raportojnë vetëm Kuvendit.

Synavere Rysha -Auditimi është një Instrument që korrigjon punën e bërë në institucione, qoftë të nivelit lokal, po ashtu edhe ato të nivelit qendror, prandaj është trajtuar gjithëherë si dukuri serioze. Fakti se tri institucione nuk kanë plotësuar format e vetëvlerësimit si ZAP, Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Gjakovës, e që janë institucione me një kredibilitet të lartë mendojë se kjo nuk duhet të tolerohet. Nga diskutimet kuptohet se MF paska qenë e gatshme të ofrojë shërbime të përbashkëta të Auditimit për Agjenci të Pavarura që nuk janë të mbuluara me Auditor të brendshëm. Mungesa e masave sanksionuese nga ana e MF për institucionet që nuk shfrytëzojnë shërbimet e përbashkëta të Auditimit paraqesin problem. Mendojë se Ministria e Financave bashkë me NJQHAB duhet të ushtroje tryzni te këto institucione, ndoshta për këtë kërkohet edhe angazhim më i madh i Kuvendit në sanksionimin, qoftë me ndalje të buxhetit apo formave të tjera.

Kimete Arifi - Po ashtu NE, si NJQHAB, kemi kërkuar nga Kuvendi të krijojë një njësi për Auditimin e Agjencisë të Pavarura e që nuk kanë Auditor të brendshëm. Ne, po ashtu, jemi diku rishikuar udhëzimin administrativ për auditim të brendshëm dhe do të caktojmë kritere të reja.

Ali Sadriu- Pyeti pse është ky numër i vogël i auditorëve të licencuar nga 149 auditorë gjithsej vetëm 67 janë të licencuar, cilat janë arsytet për këtë?

Kimete Arifi - Roli i NJQHAB është përgatitja e një kriteri rigoroz për trajnime dhe lëshimi i licencës për operim. Megjithatë deri tani NJQHAB nuk ka të drejtë të licencojë, si dhe t'i akreditojë auditorët ngase nuk ka autorizime dhe kompetenca për këtë. Komisioni evropian ka ndihmuar për këtë në ngritjen e kapaciteteve brenda njërive të Auditimit të brendshëm.

Adem Grabovci - Pyeti se auditorët e brendshëm të cilët nuk e kanë kaluar testin për auditorë të brendshëm a i gëzojnë të drejtat e njëjta sikur auditorët e licencuar?

Kimete Arifi - Aktualisht nuk ekziston ndonjë kategorizim për këtë, shpresojmë me udhëzimin e ri do të këtë diferenca të tilla varësisht prej gradës së auditorit të brendshëm. Aktualisht nuk ekziston përshkallëzim i pagës së auditorëve.

Naim Fetahu- Theksoi se një numër i konsideruar i OB-ve nuk e kanë plotësuar formën e vetëvlerësimit, më habit fakti pse ZAP nuk e ka plotësuar formën e vetëvlerësimit, kjo nuk është bërë për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore. Po ashtu disa komuna të vogla nuk i kanë plotësuar format e vetëvlerësimit. Numri prej 48 auditorëve të kërkuar, mendoj se është bërë pa ndonjë analizë të mirëfilltë, këtu duhet të shtohet numri i auditimeve dhe cilësia e tyre, ngase ka auditorë të mjaftueshëm.

Hajdar Beqa - Tha se KMFP ka shqyrtuar me kujdes raportin e NJQHAB, dhe kemi parë të metat e fushës së Auditimit të brendshëm, dhe mos zbatimi i rekomandimeve nga e kaluara, përsëritja e shkeljeve nga viti në vit. Shkeljet me të theksuara janë në prokurim, menaxhim të veturave, personel, dobësi në menaxhim të shpenzimeve, planifikim i dobët i buxhetit, regjistrimet në kode ekonomike të gabuara, janë fushat të cilat janë të regjistruara në nivel jo të kënaqshëm nga auditimet e brendshme. Për të gjitha këto të gjetura auditorët e brendshëm kanë dhënë rekomandime për mënjanimin e të metave të konstatuara gjatë auditimit në subjektet e sektorit publik të Kosovës. Janë dhënë 2480 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Prej këtyre rekomandimeve nga menaxhmenti janë implementuar 1228 (49.52%), në proces të implementimit janë 733 (29.56%), nuk janë implementuar 519 (20.93%) të rekomandimeve.

Avdullah Hoti- Shtoi se MF është duke punuar në kontinuitet për krijimin e kushteve për zbatimin e rekomandimeve, bie fjala, NE, për vetura kemi hapur ankandin publik, si dhe në kontest të GPS dhe vërehet përgjysmimi i shpenzimeve për vetura. Po ashtu në sistem të Teknologjisë Informative është duke u punuar me zyrtarët nga Free Balanca në ngritjen e një sistemi të integruar të tërë sistemit të fushës së financave publike. Përgatitja profesionale e auditorëve të brendshëm do të jetë në prioritet nga MF, mos zbatimi i rekomandimeve të auditorëve të brendshëm nuk është për fajin e tyre. Kjo është për shkak të mos interesimit të Zyrtarit Kryesor Administrativ - ZKA në zbatimin e rekomandimeve.

Ali Sadriu -Theksoi se pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar, i njoftoi të pranishmit se administrata e KMFP do të përgatisë rekomandimet për Ministrin e Financave, përkatësisht NJQHAB dhe të njëjtat do të diskutohen në mbledhjen e radhës.

Përfundim

Raporti vjetor i Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2014, nuk do të adresohet për seancë plenare, ndërsa rekomandimet për MF përkatësisht NJQHAB do të përgatiten nga administrata e KMFP-së dhe të njëjtat do të diskutohen në mbledhjen e radhës së KMFP-së.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zv. kryetari i Komisionit,

Ali Sadriu